



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
Arkivi Qendror - Centralna Arhiva - Central Archive

Nr./Br./No. 176
Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 27
Data/Datum/Date: 28/01/2014
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

DATË/A:	28.01.2014
REFERENC-Ë:	04-05/2014
PËR/ZA/TO:	z.Blerand Stavileci, Ministër i MBPZHR-së
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z.Kapllan Halimi, Sekretar i Përgjithshëm i MBPZHR-së
NGA/OD/FROM	Isuf Cikaqi, Drejtor i Departamentit të Politikave Bujqësore dhe Tregtisë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Programi për pagesa direkte 2014

I nderuari z.Ministër,

Programi për pagesa direkte për vitin 2014 është në harmoni me Programin për zhvillim Rural 2014 bazuar në programin e ri shtatëvjeçarë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural i përgatitur duke u bazuar në Raportin e vlerësimit afatmesëm të PBZHR 2007-2013, analizat SWOT të realizuara me të gjithë partnerët social dhe analizat sektoriale.

Përgatitja e programit për pagesa direkte është udhëhequr nga Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregtisë në bashkëpunim të ngushtë me partnerët social: OJQ-të, përfaqësuesit e shoqatave të fermerëve.

Bazuar në dokumentet e lartpërmendura, prioritet e identifikuar dhe buxhetin aktual, Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregtisë, për vitin 2014 ka përgatitur programin për pagesat direkte.


Programi për pagesat direkte 2014

Nr.	Sektorët që do të mbështeten përmes pagesave direkte	Buxheti (€)
1	Pagesa direkte për mbjelljen vjeshtore të grurit	5,800,000.00
2	Pagesa direkte për mbjelljen e farës së grurit	100,000.00
3	Pagesa direkte për mbjelljen pranverore të misrit	1,000,000.00
4	Pagesa direkte për mbjelljen pranverore të lulediellit	100,000.00
5	Pagesa direkte për vreshta ekzistues	1,150,000.00

6	Pagesa direkte për prodhimtarinë e materialit fidanorë të pemëve drufrutorë dhe hardhisë së rrushit mbi nënshartesat vegjetative	100,000.00
7	Pagesa direkte për lopë dhe buallica qumështore	2,000,000.00
8	Pagesa direkte për delet dhe dhitë	1,300,000.00
9	Pagesa direkte për bletari	500,000.00
10	Pagesa direkte për qumështin sipas kategorive të cilësisë	1,500,000.00
11	Pagesa direkte për prodhimtarinë e vezëve	250,000.00
12	Pagesa direkte për dosa në riprodhim (Derraria)	200,000.00
Total buxheti për vitin 2014		14,000,000.00

Duke marrë parasysh që programi do të implementohet konform akteve ligjore të nxjerra nga Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregtisë ju lutet që të aprovoni programin e propozuar për pagesat direkte për vitin 2014, në mënyrë që ti paraprijë finalizimit të rregullores dhe udhëzuesit për implementim.

Aprovoj:


 Blerand Stavileci, Ministër i Ministrisë
 së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Datë: 28.01.2014

PROGRAMI PËR PAGESAT DIREKTE 2014

PAGESAT DIREKTE PËR MBJELLJE VJESHTORE TË GRURI

1. Legjislacioni referues:

- Ligji Nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.56/27.07.2009).
- Ligji Nr.04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/16 Tetor 2012).
- Ligji Nr.03/L-016 për Ushqimin (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.49/25.03.2009).
- Ligji Nr.03/L-029 për Inspektionin Bujqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.45/12.01.2009).
- Ligji Nr 04/L-085 për Bujqësi Organike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/16 Tetor 2012).
- Ligji Nr.2003/5 i Kosovës për Farërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.8/15.12.2006).
- Udhëzim Administrativ MBPZHR Nr.02/2014 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2014.

2. Përshkrimi i sektorit - Rëndësia e bujqësisë (drithërave):

Sektori i drithërave është me rëndësi strategjike dhe ekonomike për vendin, duke u bazuar në resurse natyrore dhe numrin e madh të fuqisë punëtore të angazhuar në këtë sektor. Rëndësia e këtij sektori qëndron edhe në ndikimin që ka në zhvillimin e sektorëve të tjerë, blegtorisë dhe agro-përpunimit.

Në Kosovë, për vite me radhë mesatarisht mbillen prej 70 000 deri 85 000 hektarë me grurë. Rendimentet mesatare të realizuara sillen rreth 4 t/ha, varësisht nga kushtet agroklimatike dhe prodhueset të vendit tonë, si dhe masat e ndërmarra agroteknike.

Në vitet e fundit kemi një zhvillim më intensiv të sektorit, viteve të fundit është evidente rritja e sipërfaqeve të mbjellura me grurë për 6000 ha, krahasuar me vitet paraprake.

Për të pasur një zhvillim të qëndrueshmëri të sektorit, kërkohet mbështetje direkte përmes subvencionimit. Kjo masë mbështetëse do të ndikoj drejtpërdrejt në zvogëlimin e kostos së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave të fermerit.

Përmes kësaj mase synohet të arrihet siguri i vetëmjaftueshmërisë me grurë. Aktualisht Kosova i plotëson nevojat e veta rreth 70-80 % të konsumit me grurë.

3. Arsyeshmëria e zbatimit të masës:

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh *Përmirësimin e konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar* bujqësor. Mbështetja direkte e mbjelljeve vjeshtore (grurit) do t'i kontribuoj realizimit të kësaj objektive.

Siguri dhe siguria e ushqimit, si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsye të përkrahjes së kësaj mase, duke marrë për bazë numrin e madh të fermerëve të cilët merren me këtë sektor dhe resurset natyrore me të cilat disponon vendi.

4. Qëllimi programit:

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët kultivojnë drithëra/grurë.

4.1. Objektivat e programit:

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Përmirësimi i konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor.

4.2. Objektivat specifike:

- Rritja e rendimentit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit;
- Intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore.

5. Përfituesit/grupi i synuar

5.1. Fermerët që kultivojnë drithëra/grurë:

- Sipas kësaj mase, përfitues do të jenë të gjithë fermerët të cilët kultivojnë grurë dhe të cilët plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

5.2. Shtrirja gjeografike:

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

5.3. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët:

- Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë mbjellë së paku **2 ha tokë me grurë**;
- Parcela e mbjellur me grurë, duhet të jetë në minimum **0.20 ha**;
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qira, duhet të jetë e kontraktuar së paku për një vit;
- Sipërfaqja e marrë me qira duhet të jetë **1 ha e pandarë**;

6. Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit për personat juridik;
- Dëshminë nga kadastra mbi sipërfaqen e tokës së punueshme në pronësi ose kopjen e kontratës që dëshmon disponueshmërinë e tokës bujqësore;
- Dëshmi për pagesën e tatimit mbi pronë;
- Kontratën për sipërfaqen e tokës bujqësore të marrë me qira.

7. Mënyra e subvencionimit:

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe - hektar, në vlerë prej **125 €/ha**;
- Përfitues potencial do të jenë fermerët të cilët kultivojnë grurë me sipërfaqe mbi **2 ha**.

8. Realizimi i pagesave:

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të hektarëve të mbjellë dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB. Pagesat bëhen në xhironlogaritë bankare të fermerëve, verifikimi i së cilës është bërë gjatë aplikimit.

9. Mënyra e aplikimit:

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë 45 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtorit Komunalë për Bujqësi.

10. Buxheti i planifikuar për pagesat direkte (subvencionim) të mbjelljeve vjeshtore të grurit është 5,800,000.00 €.

11. Implementimi i programit

Implementimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

PAGESAT DIREKTE PËR MBJELLJE TË FARËS SË GRURIT

1. Legjislacioni referues:

- Ligji Nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.56/27.07.2009).
- Ligji Nr.04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/16 Tetor 2012).
- Ligji Nr.03/L-016 për Ushqimin (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.49/25.03.2009).
- Ligji Nr.03/L-029 për Inspektionin Bujqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.45/12.01.2009).
- Ligji Nr 04/L-085 për Bujqësi Organike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/16 Tetor 2012).
- Ligji Nr.2003/5 i Kosovës për Farërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.8/15.12.2006).
- Udhëzim Administrativ MBPZHR Nr.02/2014 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2014.

2. Përshkrimi i sektorit - Rëndësia e bujqësisë (drithërave):

Në Kosovë mesatarisht për çdo vit mbillen mbi 1000 ha për farë gruri. Nëse bëjmë një analizë të sipërfaqeve të mbjellura në vend (sipas viteve), kemi një rënie sistematike të sipërfaqeve të mbjellura, për shkak të mosmbështetjes direkte të kësaj lëmie, konkurrencës nga importi (vendet importuese aplikojnë politika stimuluese dhe lehtësuese për këtë sektor).

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tab.1. shihet se aktualisht Kosova i plotëson nevojat me farë gruri vetëm 10-15 %, Për shkak të kostos së lartë një pjesë e konsideruar e

fermerëve e shfrytëzojnë farën vetanake (vlerësohet se 20% e fermerëve përdorin farën vetanake për mbjellje të grurit).

Procesi i prodhimit të farës një veprimtari ekonomikisht e kushtueshme, duke i marr për bazë fazat e prodhimit: Sigurimi i farës cilësore, shumëzimi, parakultura, inspektime fushore, përpunimi, etiketimi, mostrimi i farës si dhe masat shtesë të mbrojtjes. Mbështetja e prodhuesve të farës do të ndikonte në uljen e kostos së prodhimit të farës. Përmes kësaj mase synohet të arrihet sigurimi i farës së grurit nga vendi me qëllim të rritjes së rendimentit dhe përmirësimin e cilësisë së grurit të prodhuar.

3. Arsyeshmëria e zbatimit të masës:

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh *Përmirësimin e konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar* bujqësor. Mbështetja direkte e mbjelljeve vjeshtore (farë gruri) do t'i kontribuoj realizimit të kësaj objekte.

Sigurimi dhe siguria e ushqimit, si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsytet e përkrahjes së kësaj mase, duke marrë për bazë kërkesat e tregut dhe resurset natyrore me të cilat disponon vendi.

4. Qëllimi programit:

Mbështetja direkte e prodhuesve të farës së grurit

4.1. Objektivat e programit:

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Përmirësimi i konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor;

4.2. Objektivat specifike:

- Rritja e rendimentit të grurit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit të farës së grurit dhe grurit merkantil;
- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit;
- Rritja e kapaciteteve përpunuese;
- Intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore.

5. Përfituesit/grupi i synuar

5.1. Fermerët që kultivojnë farë të grurit:

- Sipas kësaj mase, përfitues do të jenë të gjithë fermeret të cilët kultivojnë farë të grurit dhe të cilët plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

5.2. Shtrirja gjeografike:

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

5.3. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët:

- Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë mbjellë **minimum 5 ha dhe maksimum 100 ha** me grurë për prodhimin e farës;
- Të posedojnë kontratën me kompaninë prodhuese të farës;

- Dëshmin për sasinë e dorëzuara të grurit në kompaninë prodhuese të farës;
- Parcela e mbjellë me grurë për farë ose e marre me qera për mbjelljen e grurit për farë, duhet të jetë në minimum 1 ha e pandarë;
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qira, duhet të jetë e kontraktuar për një vit;
- Fara e mbjellurë duhet të jetë në Listën e Lejuar të Farës.

Tab. 1. Lista lejuar e farës për varietetet e grurit

1	ANA	33	PROFETA
2	BRUTUS	34	ANDALOU
3	EVROPA 90	35	BASTIDE
4	KRONA	36	AGROUNIJA
5	LARA	37	MAKEDONSKA RANA
6	LENTA	38	EXOTIC
7	LUNA	39	Bc RENATA
8	LIBERTA	40	Bc MIHELCA
9	ISENGRAIN	41	MIA
10	ILIRIJA	42	MATEA
11	GOLLUBICA	43	GABI
12	JUSTUS	44	EPIDOC
13	NEVESINKA	45	APACHE
14	NS 5	46	ARLEQUIN
15	PANONKA	47	ANDINO
16	POBEDA	48	BALATON
17	PELISTERKA	49	Bc PRIMA
18	RENEZANSA	50	SIRTAKI
19	SERPANJKA	51	EUCLIDE
20	TINA	52	Kg 56-S
21	SOISSONS	53	VIZIJA
22	ZHITARKA	54	KRISTINA
23	SUPER ZHITARKA	55	PLANETA
24	Mv SUBA	56	ESPERIA
25	Mv KOLO	57	AMARILO 105
26	Mv TOBORZO	58	VITTORIO
27	Mv MARSALL	59	STENDAL
28	Mv MAKARONI	60	ZANZIBAR
29	Mv BERES	61	SIMONIDA
30	AGROUNIJA PRIMA	62	ZVEZDANA
31	MAKEDONSKA RODNA	63	VULKAN
32	NIKOL		
Kultivarët standard (krahases):Evropa 90 dhe Pobeda			

6. Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit për personat juridik;
- Dëshminë nga kadastra mbi sipërfaqen e tokës së punueshme në pronësi ose kopjen e kontratës që dëshmon disponueshmërinë e tokës bujqësore;

- Dëshminë mbi kategorinë e farës së mbjellurë;
- Formularin për sipërfaqet e mbjellura (e verifikuar nga MBPZHR);
- Raportin e Inspektoriatit fitosanitar nga inspektimet fushore I dhe II;
- Dëshmi për pagesën e tatimit mbi pronë.

7. Mënyra e subvencionimit:

Pas realizimit të dy inspektimeve fushor nga ana e Inspektorve Fitosanitar, nëse parcelat i plotësojnë kriteret për fare atëherë subvencionimi do të bëhet në vlerë prej 225 €/ha. Nëse parcelat nuk i plotësojnë kriteret për fare dhe refuzohen atëherë fermerët do të përfitojnë vetëm subvencionin për prodhimtarinë e grurit merkantil në vlerë prej 125 €/ha.

8. Mënyra e implementimit:

Pas verifikimit të dokumentacionit, realizohen dy inspektime në teren nga ana e Inspektorve Fitosanitar. Inspektimi i parë realizohet pas ngallmimit të grurit, ndërsa inspektimi i dytë realizohet pas dy javëve të sipërfaqet e mbjellura me grurë për farë (Përgjegjës për inspektim është shërbimi i autorizuar-Inspektorati fitosanitar), dhe në fund behët lëshimi i raportit për sipërfaqet e grurit për farë të pranuar dhe ato të refuzuara.

9. Realizimi i pagesave:

Pas përfundimit të inspektimeve dhe hartimit të listave përfundimtare të përfituesve bëhet pagesa e fermerëve përfitues vetëm për sipërfaqet e pranuar për farë të grurit dhe dëshmisë mbi sasinë e dorëzuar të farës së grurit bazuar në rendimentin mesatar të grurit për vitin aktual. Pagesat bëhen në xhirlogaritë bankare të fermerëve, verifikimi i së cilës është bërë gjatë aplikimit.

10. Mënyra e aplikimit:

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë 45 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtorit Komunalë për Bujqësi.

11. Buxheti i planifikuar për pagesat direkte (subvencionim) të mbjelljeve të grurit për farë është 100,000.00 €.

12. Implementimi i programit

Implementimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

PAGESAT DIREKTE PËR MBJELLJE PRANVERORE / MISËR

1. Legjislacioni referues:

- Ligji Nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.56/27.07.2009).
- Ligji Nr.04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/16 Tetor 2012).

- Ligji Nr.03/L-016 për Ushqimin (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.49/25.03.2009).
- Ligji Nr.03/L-029 për Inspektionin Bujqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.45/12.01.2009).
- Ligji Nr 04/L-085 për Bujqësi Organike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/16 Tetor 2012).
- Ligji Nr.2003/5 i Kosovës për Farërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.8/15.12.2006).
- Udhëzim Administrativ MBPZHR Nr.02/2014 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2014.

2. Përshkrimi i sektorit - Rëndësia e bujqësisë (drithërave)

Në Kosovë, për vite me radhë mesatarisht mbillen prej 60,000 deri 65,000 hektarë me misër, dominon varieteti i misrit kokërr edhe pse në vitet e fundit kemi një ndryshim të strukturës në favor të rritjes së sipërfaqeve të mbjellura me misër foragjer. Rendimentet e realizuara sillen nga 4 deri në 4.5 t/ha, varësisht nga kushtet agroklimatike dhe prodhuese të vendit tonë, si dhe masat e ndërmarra agroteknike.

Për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, kërkohet mbështetja direkte përmes subvencionimit. Kjo masë mbështetëse do të ndikoj drejtpërdrejt në zvogëlimin e kostos së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave të fermerit.

Përmes kësaj mase synohet të arrihet sigurimi i vetëmjaftueshmërisë me ushqim të koncentruar për kafshë (misër). Ky veprim do të kishte refleksione edhe në uljen e kostos së prodhimeve blegtorale dhe përmirësimin e cilësisë.

3. Arsyeshmëria e zbatimit të masës:

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh *Përmirësimin e konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar* bujqësor. Mbështetja direkte e mbjelljeve pranverore (misër) do t'i kontribuoj realizimit të kësaj objekte.

Sigurimi dhe siguria e ushqimit, si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsyet e përkrahjes së kësaj mase, duke marrë për bazë numrin e madh të fermerëve të cilët merren me këtë sektor dhe resurset natyrore me të cilat disponon vendi.

4. Qëllimi programit:

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët kultivojnë drithëra/misër.

4.1. Objektivat e programit:

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Përmirësimi i konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor.

4.2. Objektivat specifike:

- Rritja e rendimentit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimeve;
- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit;
- Shfrytëzimin e kapaciteteve përpunuese të ushqimit të kafshëve
- Intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore dhe industrisë përpunuese.

5. Përfituesit/grupi i synuar

5.1. Fermerët që kultivojnë misër:

- Sipas kësaj mase, përfitues do të jenë të gjithë fermerët të cilët kultivojnë misër dhe plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

6.2. Shtrirja gjeografike:

- ↳ Tërë territori i Republikës së Kosovës.

6.3. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët:

- Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë mbjellë së paku **1 ha** me misër në pronësi;
- Parcela e mbjellë me misër, duhet të jetë në minimum **0.20 ha** e pandarë;
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qira, duhet të jetë e kontraktuar për një vit;
- Sipërfaqja e marrë me qira duhet të jetë **1 ha** e pandarë.

7. Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit për personat juridik;
- Dëshminë nga kadastra mbi sipërfaqen e tokës së punueshme, në pronësi ose kopjen e kontratës që dëshmon disponueshmërinë e tokës bujqësore;
- Dëshmi për pagesën e tatimit mbi pronë.

8. Mënyra e subvencionimit:

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe, në vlerë prej **100 € / hektar**;
- Përfitues potencial do të jenë fermerët të cilët kultivojnë mbi **1 ha** misër.

9. Realizimi i pagesave:

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të hektarëve të mbjellë dhe të verifikuar nga inspektoret e AZHB. Pagesat bëhen në xhirollogaritë bankare të fermerëve, verifikimi i së cilës është bërë gjatë aplikimit.

10. Mënyra e aplikimit:

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë **45 ditë** nga data e publikimit. Aplikimi behet ne Drejtorit Komunale për Bujqësi.

11. Buxheti i planifikuar është 1.000.000.00 €.

12. Implementimi i programit

Implementimi bëhet nga Agjencia per Zhvillimin e Bujqesise.

PAGESAT DIREKTE PËR MBJELLJE PRANVERORE - LULE DIELLI

1. Legjislacioni referues:

- Ligji Nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.56/27.07.2009).
- Ligji Nr.04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/16 Tetor 2012).
- Ligji Nr.03/L-016 për Ushqimin (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.49/25.03.2009).
- Ligji Nr.03/L-029 për Inspektionin Bujqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.45/12.01.2009).
- Ligji Nr 04/L-085 për Bujqësi Organike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/16 Tetor 2012).
- Ligji Nr.2003/5 i Kosovës për Farërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.8/15.12.2006).
- Udhëzim Administrativ MBPZHR Nr.02/2014 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2014.

2. Përshkrimi i sektorit - Rëndësia e bujqësisë (drithërave):

Lule dielli është kulturë industriale dhe luan rrol të rëndësishëm në industrinë ushqimore dhe atë përpunuese. Përdoret si lëndë e parë në industrinë e vajit, ushqim për kafshët (bimë e gjëlbert, e silazhuar) si dhe mbetje të përpunimit industrial (bërsi). Në të kaluarën e afërt dmth. në vitet e 80 -90-ta kjo kulturë është kultivuar në sipërfaqe të mëdha në arat e Kosovës . Sipërfaqet mbjellëse me këtë kulturë janë sjellë mbi 10.000 hektarë dhe rendimenti mesatar ka qenë mbi 2000 kg për hektar.

Në Kosovë, për vite me radhë nuk është kultivuar lule dielli, por viteve të fundit ka filluar të shfaqet interesimi për kultivimin e kësaj kulture vajore. Për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, kërkohet mbështetja direkte përmes subvencionimit. Kjo masë mbështetëse do të ndikoj drejtpërdrejt në zvogëlimin e kostos së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave të fermerit.

Përmes kësaj mase synohet të arrihet sigurimi i lëndes së parë për prodhimin e vajit dhe ushqimit të koncentruar për bagëti. Ky veprim do të kishte refleksione edhe në uljen e kostos së prodhimeve blegtorale dhe përmirësimin e cilësisë.

3. Arsyeshmëria e zbatimit të masës:

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh *Përmirësimin e konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar* bujqësor. Mbështetja direkte e mbjelljeve pranverore (lule dielli) do t'i kontribuoj realizimit të kësaj objekte.

Sigurimi dhe siguria e ushqimit, si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsyt e përkrahjes së kësaj mase, duke marrë për bazë numrin e madh të fermerëve të cilët merren me këtë sektor dhe resurset natyrore me të cilat disponon vendi.

4. Qëllimi programit:

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët kultivojnë lule dielli.

4.1. Objektivat e programit:

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Përmirësimi i konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor.

4.2. Objektivat specifike:

- Rritja e rendimentit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit;
- Shfrytëzimin e kapaciteteve përpunuese të ushqimit të kafshëve
- Intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore dhe industrisë përpunuese

5. Përfituesit/grupi i synuar

5.1. Fermerët që kultivojnë lule dielli:

Sipas kësaj mase, përfitues do të jenë të gjithë fermerët të cilët kultivojnë lule dielli dhe plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

5.2. Shtrirja gjeografike:

- ↳ Tërë territori i Republikës së Kosovës.

5.3. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët:

- Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë mbjellë së paku **1 ha** me lule dielli në pronësi;
- Parcela e mbjellë me lule dielli, duhet të jetë në minimum **0.20 ha** e pandarë;
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qera, duhet të jetë e kontraktuar për një vit;
- Sipërfaqja e marrë me qera duhet të jetë **1 ha** e pandarë;

6. Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit për personat juridik;
- Dëshminë nga kadastra mbi sipërfaqen e tokës së punueshme në pronësi ose kopjen e kontratës që dëshmon disponueshmërinë e tokës bujqësore;
- Dëshmi për pagesën e tatimit mbi pronë.

7. Mënyra e subvencionimit:

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe, në vlerë prej **100 € / hektar**.
- Përfitues potencial do të jenë fermerët të cilët kultivojnë mbi **1 ha** lule dielli.

8. Realizimi i pagesave:

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të hektarëve të mbjellë dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB. Pagesat bëhen në xhirollogaritë bankare të fermerëve, verifikimi i së cilës është bërë gjatë aplikimit.

9. Mënyra e aplikimit:

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë 45 ditë nga data e publikimit. Aplikimi behet ne Drejtorit Komunale për Bujqësi.

10. Buxheti i planifikuar është 1 00,000.00 €.

11. Implementimi i programit:

Implementimi bëhet nga Agjencia per Zhvillimin e Bujqesise.

PAGESAT DIREKTE PËR VRESHTA

1. Legjislacioni referues:

- Ligji Nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.56/27.07.2009).
- Ligji Nr.04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/16 Tetor 2012).
- Ligji Nr.03/L-016 për Ushqimin (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.49/25.03.2009).
- Ligji Nr.03/L-029 për Inspektionin Bujqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.45/12.01.2009).
- Ligji Nr 04/L-085 për Bujqësi Organike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/16 Tetor 2012).
- Ligji Nr.02/L-8 për Verërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.9/01.02.2007).
- Ligji Nr.04/L-019 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.02/L-8 për Verërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.13/01.09.2011).
- Udhëzim Administrativ MBPZHR Nr.02/2014 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2014.

2. Përshkrimi i sektorit - Rëndësia e bujqësisë (vreshtave):

Sektori i vreshtarisë është me rëndësi strategjike dhe ekonomike për vendin, duke u bazuar në resurse natyrore dhe numrin e madh të fuqisë punëtore të angazhuar në këtë sektor. Rëndësia e këtij sektori qëndron edhe në ndikimin që ka në zhvillimin e sektorëve të tjerë, si ne sektorin e verërave, tregtisë dhe agro-përpunimit.

Sipas të dhënave, nga kadastri i vreshtave, ne Kosovë aktualisht janë 3300 ha me vreshta dhe më shumë 5000 fermer që merren direkt më kultivimin e vreshtit.

Në vitet e fundit kemi një zhvillim më intensiv të sektorit, janë bërë investime të rëndësishme në sektorin e vreshtave dhe verërave (afër 500 ha me vreshta te reja janë mbjellja nga viti 2009 e këtej. Për të pasur një zhvillim te qëndrueshëm të sektorit, kërkohet vazhdimi i mbështetjes direkte përmes subvencionimit. Kjo masë mbështetëse do të ndikoj drejtpërdrejt në zvogëlimin e kostos së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave të fermerit.

Përmes kësaj mase synohet të arrihet mirëmbajtje e vazhdueshme e sipërfaqeve aktuale dhe shtimi i sipërfaqeve te reja me vresht.

3. Arsyeshmëria e zbatimit të masës:

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh *Përmirësimin e konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar* bujqësor. Mbështetja direkte e mirëmbajtjes së sipërfaqeve më vreshta do t'i kontribuoj realizimit të kësaj objektive.

Sigurimi dhe siguria e ushqimit, si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsye të përkrahjes së kësaj mase, ruajtja dhe zgjerimi i sipërfaqeve me vreshta, ndalimin e imigrimit nga zonat rurale në zonat urbane si dhe duke marrë për bazë numrin e madh të fermerëve të cilët merren me këtë sektor dhe resurset natyrore me të cilat disponon vendi.

4. Qëllimi programit:

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët kultivojnë vresht (rrush).

4.1. Objektivat e programit:

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Mirëmbajtja e vazhdueshme e vreshtave ekzistues;
- Përmirësimi i konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor.

4.2. Objektivat specifike:

- Rritja e rendimentit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit;
- Intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore.

5. Përfituesit/grupi i synuar:

5.1. Fermerët që kultivojnë Vreshta (rrush)

- Sipas kësaj mase, përfitues do të jenë të gjithë fermerët të cilët kultivojnë vresht (rrush) dhe plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

5.2. Shtrirja gjeografike:

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

5.3. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët:

- Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellurë së paku **0.10 ha (10 ari)** më vresht;
- Sipërfaqja e vreshtit e marrë me qera, duhet të jetë e kontraktuar për një vit;
- Sipërfaqja e vreshtit e marrë me qera duhet të jetë **0.10 ha (10 ari)** e pandarë.

6. Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit për personat juridik;

- Dëshminë nga kadastri i vreshtarisë mbi sipërfaqen e vreshtit - certifikata e vreshtit (ky dokument merret ne Entin e vreshtarisë dhe verërave ne Rahovec);
- Dëshmi për pagesën e tatimit mbi pronë.

7. Mënyra e subvencionimit:

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe - hektar;
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kultivojnë me shume se 0.10 ha (10 ari) vreshtë;
- Fermerët që kanë të mbjellurë (kultivojnë) vresht nga 0.10 ha deri 100 ha do të subvencionohen në vlerë prej 500 €/ha;
- Fermerët që kanë të mbjellurë (kultivojnë) vresht mbi 100 ha do të subvencionohen në vlerë prej 200 €/ha.

8. Realizimi i pagesave:

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të hektarëve të mbjellë dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB. Pagesat bëhen në xhironlogaritë bankare të fermerëve, verifikimi i së cilës është bërë gjatë aplikimit.

9. Mënyra e aplikimit:

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, do të zgjatë 45 ditë nga data e publikimit. Aplikimi behet ne Drejtorit Komunale për Bujqësi.

10. Buxheti i planifikuar për pagesat direkte për vreshta është 1,150,000.00 €.

11. Implementimi i programit:

Implementimi bëhet nga Agjencia per Zhvillimin e Bujqesise.

PAGESAT DIREKTE PËR PRODHIMIN E MATERIALIT FIDANOR TË PEMËVE DRUFRUTORE DHE HARDHISË SË RRUSHIT TË PRODHUARA MBI NËNSHARTESA VEGJETATIVE

1. Legjislacioni referues:

- Ligji Nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.56/27.07.2009).
- Ligji Nr.04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/16 Tetor 2012).
- Ligji Nr.2004/13 për Materialin Fidanor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.22/01.03.2008).
- Ligji Nr 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.01/17 Janar 2013).
- Ligji Nr.03/L-029 për Inspektionin Bujqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.45/12.01.2009).

- Ligji Nr 04/L-085 për Bujqësi Organike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/16 Tetor 2012).
- Udhëzim Administrativ MBPZHR Nr.02/2014 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2014.

2. Përshkrimi i sektorit - Rëndësia e materialit fidanor

Zhvillimi i suksesshëm i pemëtarisë intensive varet në radhë të parë nga prodhimtaria cilësore e materialit fidanor, nga varietete me të mira të përfituara për mes seleksionimit klonal, të kultivuara në nënshartesat me të përshtatshme.

Suksesi në krijimin e pemishteve intensive komerciale, në radhë të parë varet nga kualiteti i fidanëve, prandaj kësaj prodhimtarie gjithmonë duhet ti kushtohet kujdes i veçantë, sidomos sigurimit të materialit fillestar, i cili para se gjithash duhet të jetë i shëndoshe për nga gjendja shëndetësore dhe pastërtia varietore, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të garantohet prodhimtaria e qëndrueshme e pemishtes.

Viteve të fundit është rritë në mënyrë të dukshëm interesimi i fermerëve për prodhimin e materialit fidanor të pemëve të prodhuara mbi nënshartesa vegjetative. Sektori pemëtarisë e veçanërisht prodhimtaria e fidanëve konsiderohet sektorë me rendësi ekonomike për bujqësinë kosovare ku vitet e fundit po i kushtohet një mbështetje dhe zhvillim me i madhe si nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural po ashtu edhe nga organizatat që veprojnë në Kosovë.

Përmes kësaj mase synohet të arrihet përmirësimi i teknikave të prodhimit të fidaneve të pemëve dhe aplikimit të teknologjive të reja që bëjnë të mundur rritjen e vazhdueshme të cilësisë dhe shtimin e numrit të fidanëve të pemëve drufrutore.

3. Arsyeshmëria e zbatimit të masës:

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh *Përmirësimin e konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar* bujqësor. Mbështetja direkte në prodhimin e fidaneve të pemëve drufrutore që do t'i kontribuoj realizimit të kësaj objekte.

Ngritja e cilësisë si dhe rritja e numrit të fidaneve të pemëve drufrutore, si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsytet e përkrahjes së kësaj mase, duke marrë për bazë numrin e fermerëve të cilët merren me këtë sektor dhe resurset natyrore me të cilat disponon vendi.

4. Qëllimi programit:

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët merren me prodhimin e fidaneve të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit mbi nënshartesa vegjetative.

4.1. Objektivat e programit:

- Rritja e sipërfaqeve të mbjellura me pemë drufrutore;
- Rritja e sipërfaqeve të mbjellura me vreshta të reja;
- Rritja e të hyrave në fermë;
- Zvogëlimi i importit;
- Përmirësimi i konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor.

4.2. Objektivat specifike:

- Përmirësimi i cilësisë së materialit fidanor të pemëve drufrutore dhe hardhisë se rrushit mbi nënshartesa vegjetative;
- Aplikimi i teknologjive bashkëkohore - mbjellja intensive;
- Përmirësimi i strukturës varietore;
- Zvogëlimi i kostos së shpenzimeve të prodhimit të fidanëve të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit mbi nënshartesa vegjetative;
- Intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore.

5. Përfituesit/grupi i synuar.

5.1. Fermerët që prodhojnë material fidanor të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit mbi nënshartesa vegjetative dhe plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

5.2. Shtrirja gjeografike:

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

5.3. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët:

- Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Te posedojn minimum 0.50 ha toke bujqësore (në pronësi të tyre ose të marrur me qera);
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qira, duhet të jetë e kontraktuar së paku për 2 (dy) vite;
- Fermeri duhet të prodhoj gjatë vitit kalendarik 2014, minimum 5000 fidane të pemëve drufrutore ose hardhisë së rrushit mbi nënshartesa vegjetative.
- Fermeri mundë të përfitoj nga kjo masë për maksimum 100,000 fidane të prodhuara të pemëve drufrutore ose hardhisë së rrushit mbi nënshartesa vegjetative.

6. Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të subjektit;
- Kopjen e certifikatës së biznesit dhe informatën mbi biznesin;
- Kopjen e certifikatës së numrit fiskal;
- Dëshmin – vërtetimin për obligimet e kryera ndaj ATK;
- Kopjen e Licencës së MBPZHR për prodhimin e materialit fidanor të pemëve;
- Kopjen e Licencës së MBPZHR për prodhimin e materialit fidanor të hardhisë së rrushit;
- Kopjen e deklartimit të sasisë së prodhuar të fidaneve për vitin kalendarik 2014 të vërtetuar nga Inspektori Fitosanitar (ky dokument merret në DPBT-MBPZHR);
- Kopjen e certifikatës fitosanitare mbi gjendjen shëndetsore të fidaneve të prodhuar (ky dokument sillet pas bërjes së analizave të fidaneve për gjendjen shëndetësore);
- Dëshmin – procesverbalin nga Inspektori Fitosanitar për posedimin e përmishtës amë të nënshartësve vegjetative;

- Dëshminë – procesverbalin nga Inspektori Fitosanitar për posedimin e vreshtit amë të nënshartesave vegetative;
- Për nënshartesat vegetative të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit të sjellura nga importi, fermeri duhet të posedoj këto dokumentacione: certifikatën fitosanitare për gjendjen shëndetsore të nënshartesave vegetative të leshuar nga vendi-shteti prej të cilit janë importuar nënshartesat vegetative dhe dokumentin unik doganor (DUD) që dëshmon se nënshartesat janë futur në Kosovë në mënyrë të rregullt përmes doganës;
- Dëshminë nga kadastra mbi sipërfaqen e tokës së punueshme në pronësi ose kopjen e kontratës që dëshmon disponueshmërinë e tokës bujqësore;
- Dëshmi për pagesën e tatimit mbi pronë.

7. Mënyra e subvencionimit:

- Subvencionimi do të bëhet për fidan;
- Subvencionimi do të bëhet vetëm për fidanet një vjeçar;
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët gjatë vitit 2014 prodhojnë mbi 5000 fidane të pemëve drufrutore ose hardhisë së rrushit mbi nënshartesa vegetative;
- Fermerët që prodhojnë minimum 5,000 deri 25,000 fidane të pemëve drufrutore mbi nënshartesa vegetative do të subvencionohen në vlerë prej 0.20 €/fidan;
- Fermerët që prodhojnë mbi 25,000 deri 50,000 fidane të pemëve drufrutore mbi nënshartesa vegetative do të subvencionohen në vlerë prej 0.15 €/fidan;
- Fermerët që prodhojnë mbi 50,000 deri 100,000 fidane të pemëve drufrutore mbi nënshartesa vegetative, do të subvencionohen në vlerë prej 0.10 €/fidan;
- Fermerët që prodhojnë mbi 5,000 deri maksimumi 100,000 fidane të hardhisë së rrushit do të subvencionohen në vlerë prej 0.10 €/fidan;

8. Mënyra e aplikimit:

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë 45 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtorit Komunal për Bujqësi.

9. Realizimi i pagesave:

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të fidanëve të verifikuar nga inspektorët e AZHB. Pagesat bëhen në xhironlogaritë bankare të fermerit (subjektit), verifikimi i së cilës është bërë gjatë aplikimit.

10. Buxheti i planifikuar për pagesat direkte (subvencionim) të fidaneve të pemëve drufrutore ose hardhisë së rrushit të prodhuara mbi nënshartesa vegetative është 100,000.00 €.

11. Implementimi i programit

Implementimi bëhet nga Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë.

**PAGESAT DIREKTE PËR: LOPË DHE BUALLICA QUMËSHTORE, DELE, DHI,
DOSA PER RIPRODHIM, BLETË, QUMËSH TIN SIPAS KATEGORIVE TË
CILËSISË DHE PRODHIMTARIN E VEZËVE**

1. Legjislacioni referues:

- Ligji Nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.56/27.07.2009).
- Ligji Nr.04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/16 Tetor 2012).
- Ligji Nr.03/L-016 për Ushqimin (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.49/25.03.2009).
- Ligji Nr.03/L-029 për Inspektionin Bujqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.45/12.01.2009).
- Ligji Nr 04/L-085 për Bujqësi Organike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/16 Tetor 2012).
- Ligji Nr.2004/21 për Veterinarinë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/01.11.2007).
- Ligji Nr. 04/L-191 për Blegtorinë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.25/08 Korrik 2013).
- Ligji Nr.02/L-10 për Përkujdesjen Ndaj Kafshëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.5/01.10.2006).
- Ligji Nr.02/L-111 për Bletari (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.35/15.08.2008).
- Udhëzim Administrativ MBPZHR Nr.02/2014 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2014.

2. Rëndësia e blegtorisë - Përshkrimi i sektorit

Blegtoria është veprimtari profitabile me rëndësi ekonomike pasi që ekzistojnë resurset natyrore për zhvillimin e aktiviteteve blegtorale. Blegtoria është prodhuese e ushqimeve me vlerë të lartë ushqyese (qumësht, mish dhe prodhime bletare) dhe promotorë i zhvillimit të aktiviteteve tjera bujqësore (prodhimtarisë bimore dhe industrisë përpunuese). Numri i fermave blegtorale të regjistruara sillet rreth 96.000 (AUV) . Edhe përkundër rezultateve inkurajuese dhe predispozitive gjeografike, resurseve me të cilat disponon vendi për zhvillimin e sektorit të blegtorisë, në këtë sektor janë evidente vështirësi të cilat mund të reflektohen negativisht në zhvillimin e përgjithshëm të aktiviteteve blegtorale. Pamundësia e fermerëve për investime me qëllim të rritjes së kapaciteteve, sistemi kreditues i pavolitshëm, importet nga vendet kryesisht të regjionit të cilët aplikojë masa stimuluese për eksport (subvencionimi i eksportit) etj. paraqesin problem serioz për prodhimtarinë vendore dhe perspektivën e sektorit.

3. Arsyeshmëria e masës:

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh intensifikimin e aktiviteteve blegtorale me qëllim të shfrytëzimit të resurseve natyrore me të cilat disponon vendi dhe krijimin e një farmingu të konsoliduar profitabil me prodhimtari konkurrente në regjion dhe garanci për shëndetin e konsumatorit.

Ngritja e prodhimtarisë kërkon edhe ngritjen kapaciteteve përpunuese dhe intensifikimin e shkallës së shfrytëzimit të kapaciteteve përpunuese aktuale. Vëmendje e veçantë do të kushtohet ngritjes së nivelit të sigurisë së konsumatorit gjë që pretendohet të arrihet përmes:

- Ngritjes së madhësisë së fermave dhe modernizimi i teknologjive,
- Sigurimit të aplikimit të standardeve të sigurisë së ushqimit dhe
- Minimizimit të efekteve anësore në ndotjen e ambientit.

4. Qëllimi programit

Mbështetja direkte për fermerët mbarështues të lopëve dhe buallicave qumështore, deleve, dhive, bletëve dhe qumështit të freskët Klasa ekstra, Klasa I-rë dhe Klasa II-të.

5. Objektivat e programit:

5.1 Objektivat e përgjithshme

- Përmirësimi i të hyrave në fermë;
- Rritja e madhësisë së fermës.

5.2 Objektivat specifike

- Intensifikimin e ekonomizimit të aktiviteteve blegtorale dhe bletare;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimeve;
- Ulja e kostos së shpenzimeve të prodhimit;
- Nxitja e aktiviteteve të fermerëve dhe aftësisë konkurruese.

6. Programi i pagesave direkte për vitin 2014 mbështet këto kategori blegtorale:

6.1. Pagesat direkte për Lopët dhe buallicat qumështore

Gjedhët (duke përfshirë edhe buallicat) janë popullacioni më i madh i kafshëve blegtorale dhe si i tillë janë bartës të prodhimtarisë së qumështit, prandaj prodhimtaria e gjedhit është veprimtari i pjesës dërmuese të fermave komerciale dhe ekonomive familjare.

Vlerësohet se në vend fondi i gjedhit është mbi 260,000 krerë prej të cilave për prodhimtarinë e qumështit janë 145,600 krerë.

6.2. Përfituesit/grupi i synuar:

Përfitues sipas kësaj mase do të jenë të gjithë fermerët të cilët mbarështojnë lopë dhe buallica qumështore në të gjitha fazat e prodhimtarisë së qumështit.

6.3. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët:

- Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
- Fermerët duhet të mbarështojnë 5 e më shumë lopë qumështore dhe buallica qumështore ose gjithsej 5 krerë lopë qumështore dhe buallica qumështore së bashku;
- Fermerët mundë të përfitoj nga kjo masë për maksimum 50 krerë lopë qumështore dhe buallica qumështore në prodhimtari aktive të qumështit;

- Kafshët duhet të jenë të matrikuluara me matrikull të Republikës së Kosovës,
- Kafshët duhet të jenë të regjistruara në sistemin e Identifikimit dhe të Regjistrimit të kafshëve në AUV;

6.4. Dokumentacioni i nevojshëm:

- Fotokopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
- Regjistrin e lëshuar nga Praktikat veterinare të kontraktura duke u bazuar në të dhënat e sistemit të Identifikimit & Regjistrimit të kafshëve në AUV;
- Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë.

6.5. Mënyra e subvencionimit

- Subvencionimi do të bëhet për krerë;
- Shuma e subvencionimit do të jetë **50 euro/krerë** për të gjithë fermerët që plotësojnë kriteret e parashtruara në këtë program.

7. Pagesat direkte për Delet dhe Dhitë

Të imëtat (delet dhe dhitë) janë popullacioni i kafshëve blegtorale që dominojnë në zonat e thella rurale dhe si të tilla janë bartës të prodhimtarisë blegtorale, prandaj prodhimtaria e të imëtave është veprimtari i pjesës dërmuese të fermave komerciale dhe ekonomive familjare në zonat e thella rurale. Vlerësohet se në vend fondi i të imëtave është rreth: 140,000 krerë prej të cilave në prodhimtarinë e qumështit janë 120,000 krerë.

7.1. Përfituesit/grupi i synuar:

- Përfitues sipas këtij programi do të jenë fermerët të cilët mbarështojnë **dele** dhe **dhi** qumështore në të gjitha fazat e prodhimtarisë së qumështit.

7.2 Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët:

- Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës
- Fermerët duhet të mbarështojnë **30** e më shumë krerë dele dhe **20** e më shumë krerë dhi qumështore në prodhimtarinë aktive të qumështit;
- Fermerët mund të përfitojnë nga kjo masë për maksimum **500** krerë dele dhe dhi qumështore aktive në prodhim;
- Kafshët duhet të jenë të matrikuluara me matrikull të Republikës së Kosovës;
- Kafshët duhet të jenë të regjistruara në sistemin e Identifikimit dhe të Regjistrimit të kafshëve në AUV;

7.3. Dokumentacioni i nevojshëm:

- Fotokopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
- Regjistrin e lëshuar nga Praktikat veterinare të kontraktura duke u bazuar në të dhënat e sistemit të Identifikimit & Regjistrimit të kafshëve në AUV;
- Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë.

7.4 Mënyra e subvencionimit

- Subvencionimi do të bëhet për krerë;
- Shuma e subvencionimit do të jetë **10 euro/krerë** për të gjithë fermerët që plotësojnë kriteret e parashtruara në këtë program.

8. Pagesat direkte për Bletari

Bletaria është një ndër lëmit kyçe të bujqësisë në Kosovë. Kosova disponon kushte të përshtatshme për zhvillimin e bletarisë duke u bazuar në disponueshmerin e rrallë të klimës, reliefit apo edhe numrit të madhe të bimëve mjaltëdhënëse, të cilat garantojnë një prodhimtari të mirë të produkteve të bletës.

8.1 Përfituesit/grupi i synuar:

- Përfitues sipas këtij programi do të jenë fermeret të cilët mbarështojnë bletë.

8.2. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët:

- Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Fermerët duhet të mbarështojnë **30** e më shumë shoqëri bletësh (koshere);
- Fermerët mundë të përfitojnë nga kjo masë për maksimum **500** shoqëri bletësh (koshere);
- Fermeret mundë ti kenë të vendosura shoqëritë e bletëve (kosheret) më së shumti në tri (3) bletishte;
- Kosheret duhet të jenë të shënuara me numër identifikues të pronës sipas një rregullimi të brendshëm nga MBPZHR dhe fermerët do të njoftohen në momentin e aplikimit.

8.3. Dokumentacioni i nevojshëm:

- Fotokopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
- Dëshmi për pagesën e tatimit mbi pronë,
- Fotokopjen e certifikatës për prodhimin organik të mjaltit. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga trupa certifikues.
- Fermerët e certifikuar për prodhimin organik të mjaltit, fotokopjen e certifikatës duhet të ja bashkangjesin dokumentacionit jo më larg se 10 dite nga data e certifikimit.

8.4. Mënyra e subvencionimit:

- Subvencionimi do të bëhet për shoqëri bletësh (koshere);
- Shuma e subvencionimit do të jetë **10 euro/shoqëri bletësh (koshere)**, ndërsa fermerët e certifikuar për prodhimtari organik të mjaltit subvencionohen në shume prej **15 euro/shoqëri bletësh (koshere)**, për të gjithë fermerët - bletarët që plotësojnë kriteret e parashtruara në këtë program.

9. Pagesat direkte për qumështin sipas kategorive të cilësisë

Me këtë program rregullohen kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të subvencioneve të qumështit sipas kategorive të cilësisë për vitin 2014 bazuar në legjislacionin në fuqi. Të drejtën e shfrytëzimit të subvencioneve kanë të gjithë personat juridik dhe fizik, bartës të ekonomive familjare, komerciale dhe jo komerciale.

9.1 Përfituesit/grupi i synuar:

- Përfitues do të jenë fermerët prodhues të qumështit Klasa ekstra, Klasa I-rë dhe Klasa II-të sipas standardeve të kategorizimit bazuar në legjislacionin në fuqi.

9.2 Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët:

Përfitues të kësaj mase janë personat fizik ose juridik të cilët duhet;

- a) Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- b) Të jenë të regjistruar në regjistrin e bizneseve të Kosovës (personat juridik);
- c) Të jenë të regjistruara në sistemin e Identifikimit dhe të Regjistrimit të kafshëve në AUV dhe të posedojnë listën e verifikimit të kafshëve;
- d) Të kenë kontratën për shitjen e qumështit me ndonjërin nga qumështoret e licencuar në Kosovë;
- e) Të ofrojnë dëshmi për cilësinë e qumështit të dorëzuar në qumështore të lëshuar nga laboratorit i AUV, të pranueshëm janë qumështi i kategorive: Ekstra, Klasi I dhe Klasi II;
- f) Të ofrojnë dëshmi për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar) në ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë;
- g) Të ofrojnë dëshmi bankare për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar);

9.3. Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës (për personat fizik) ose kopjen e regjistrimit të biznesit (për persona juridik), dokumentin i cili vërteton se kush e ka autoritetin që të nënshkruaj për kompaninë;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopjen e listës së verifikimit të gjedhëve të lëshuar nga Sektori për Identifikim dhe Regjistrim (I & R) në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës (AUV);
- Kopjen e kontratës për furnizim me qumësht të lëshuar nga qumështorja,
- Dëshminë për sasinë e qumështit të dorëzuar në qumështore sipas cilësisë,
- Dëshminë për pjesëmarrjen në projektin "Transparenca dhe neutraliteti i marrjes së mostrave të qumështit"
- Dëshmi për pagesën e tatimit mbi pronë

9.4. Mënyra e realizimit të subvencionit:

- Përfituesi i subvencionimit, mbështetjen financiare (subvencionin) e realizon vetëm nëse e dorëzon (shet) qumështin përmes industrisë përpunuese - qumështoreve të licencuara;

- Përfituesi e realizon të drejtën në subvencion nëse ofron dëshmi bankare për transferimin e pagesës mujore për qumështin e shitur në qumështoren e licencuar, sasinë mujore të qumështit dhe kategorinë sipas cilësisë;
- Dorëzon më së paku 1500 litra qumësht për 3 (tre) muaj (sipas tremujorëve të viti kalendarik).

9.5. Mënyra e pagesës së subvencioneve:

Subvencionimi do të bëhet për njësi litër qumësht të dorëzuar në qumështore të licencuar sipas kategorisë për cilësi:

1. Ekstra klasa.....0.06 €
2. Klasa e I.....0.04 €
3. Klasa e II.....0.02 €
4. Klasa e III.....0.00 €

9.6. Sistemi i monitorimit

Ne funksion të implementimit të suksesshëm të masës do të nënshkruhet një memorandum bashkëpunimi me palët e interesit (MBPZHR, AUV, AZHB, SHQK, SHPQK), ne të cilin do të precizohen në mënyrë të detajuar përgjegjësit e palëve në implementimin e kësaj mase.

9.7. Garantimi i Çmimit:

Kontratat për furnizim me qumësht në mes të qumështores dhe fermerit paraqet kushtet e pagesës së qumështit.

Çmimi vjetorë bazë sipas sezonit, duhet të jetë i aprovuar sipas marrëveshjes së nënshkruar nga shoqatat e prodhuesve dhe përpunuesve të qumështit dhe për të njëjtën duhet të informohet MBPZHR.

9.8. Realizimi i pagesave për qumësht sipas kategorive të cilësisë

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve bëhet pagesa e fermerëve përfitues sipas kategorisë së cilësisë së qumështit. Pagesat bëhen në xhirollogaritë bankare të fermerëve, verifikimi i së cilës është bërë gjatë aplikimit.

9.9. Thirrja për aplikim për pagesa direkte të qumështit sipas kategorive të cilësisë

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve për pagesa direkte të qumështit sipas kategorive të cilësisë do të zgjatë 45 ditë nga data e publikimit. Aplikimi behet ne Drejtorit Komunalë për Bujqësi.

10. Pagesat direkte për Prodhimtarin e vezëve

Sektori i shpëztarisë, posaçërisht prodhimi i vezëve për konsum është shumë i rëndësishëm dhe mjaft i ndjeshëm në Kosovë, për shkak të strukturës së fermave. Shpendaria në vite ka pasur rritje të konsideruar falë ekzistimit të kapaciteteve si teknike dhe njerëzore. Vlerësohet të jetë sektori më i konsoliduar i prodhimtarisë shtazore. Sipas të dhënave ky sektorë ka arritur shkallë të lartë konkurrshmërisë, vetmajftueshmërisë dhe të konsolidimit. Megjithatë fermerët

janë përballur me probleme të natyrave të ndryshme: tregu pa qëndrueshëm dhe oscilimeve të shpeshta të çmimeve të ushqimit në treg. Aktualisht fondi i pulave vojëse vlerësohet të jetë rreth 765,000 pula vojëse.

10.1 Përfituesit/grupi i synuar:

- Përfitues potencial do të jenë fermerët mbarështues të pulave vojëse në të gjitha fazat e prodhimit aktive, të cilët plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

10.2. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të mbarështojnë mbi 2,400 pula vojëse në të gjitha fazat e prodhimit aktive të vezëve;
- Të dëshmojë origjinën e pulave vojëse (zogëzave);
- Të ketë certifikatën shëndetësore për gjendjen e tufës së pulave vojëse;

10.3. Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës
- Kopjen e certifikatës së biznesit;
- Kopjen e certifikatës së numrit fiskal,
- Dëshmi – vërtetimin për obligimet e kryera ndaj ATK-së;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të subjektit;
- Kopjen e dëshmisë për numrin dhe origjinën e pulave, fatura e furnizimit nga importuesi dhe prodhuesi,
- Certifikata veterinare-shëndetësore e lëshuar nga Praktikat veterinare të licencuara nga AUV,
- Dëshmi për pagesën e tatimit mbi pronë

10.4 Mënyra e subvencionimit

- Subvencionimi do të bëhet për njësi/pulë vojëse në të gjitha fazat në prodhimtarinë aktive të vezëve sipas madhësisë së tufës;
- Subvencionimi bëhet vetëm për një turnus të prodhimit gjatë viti kalendarik nga 1 janari deri më 31 tetor 2014, por duke marrë parasysh edhe 2 muajt e fundit të viti paraprak;
- Subvencionohen vetëm zogëzat nga 18 (tetëmbëdhjetë) javë dhe pulat vojëse në të gjitha fazat e prodhimit të vezëve.

Madhësia e tufës

Shuma e pagesës direkte për pulë vojëse

- Nga 2,400 deri 10,000 pula vojëse.....0.50 €/pulë vojëse
- Mbi 10,000 deri 20,000 pula vojëse.....0.40 €/pulë vojëse
- Mbi 20,000 pula vojëse.....0.30 €/pulë vojëse

11. Pagesat direkte për Dosat për riprodhim

Derri si kategori e kafshëve blegtorale shfrytëzohet për prodhimtarinë e mishit dhe atë kryesisht në ekonomitë familjare. Sipas të dhënave statistikore të Agjencionit të Statistikave të Kosovës (ASK) rezulton se fondi i derrave në vitin 2012 është 35,124 krerë ndërsa i krerëve të dosave për riprodhim sillet rreth 8,000 – 10,000 krerë. Gjithnjë sipas të dhënave nga analizat zooteknike rezulton se shkalla e shtimit të derrave në vend është 2 pjellje në vit me mesatare 8 gica / pjellje. Prodhimtarinë e mishit të derrit janë orientuar në plotësimin e nevojave të ekonomive familjare me tendencë ngritjen në nivel të fermave komerciale.

11.1. Përfituesit/grupi i synuar:

- Përfitues sipas kësaj mase do të jenë fermerët që mbarështojnë dosa për riprodhim në të gjitha fazat e riprodhimit, të cilët plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

11.2 Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët:

- Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Fermerët duhet të mbarështojnë 2 e më shumë dosa për riprodhim aktivë në të gjitha fazat e riprodhimit;
- Kafshët duhet të jenë të matrikuara me matrikull të Republikës së Kosovës;
- Të jenë të regjistruara në sistemin e Identifikimit dhe të Regjistrimit të kafshëve në AUV;

11.3 Dokumentacioni i nevojshëm:

- Fotokopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të fermerit;
- Regjistrin e lëshuar nga Praktikat veterinarë të kontraktura duke u bazuar në të dhënat e sistemit të Identifikimit & Regjistrimit të kafshëve në AUV;
- Dëshmi për pagesën e tatimit mbi pronë.

11.4. Mënyra e subvencionimit:

- Subvencionimi do të bëhet për krerë;
- Shuma e subvencionimit do të jetë **20 euro/krerë** për të gjithë fermerët që plotësojnë kriteret e parashtruara në këtë program.

12. Shtrirja gjeografike:

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

13. Thirrja për aplikim për pagesa direkte për krerë të bagëtive, koshere të bletëve dhe pulave për prodhimtarinë e vezëve:

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve për pagesa direkte për lopë qumështore, buallica qumështore, dele, dhi, dosat për riprodhim, bletë dhe pulave për prodhimtarinë e vezëve, do të zgjatë **45 ditë** nga data e publikimit. Aplikimi behet ne Drejtorit Komunale për Bujqësi.

14. Realizimi i pagesave për krerë të bagëtime, koshere të bletëve dhe pulave për prodhimtarinë e vezëve:

Realizimi i pagesave direkte për lopë qumështore, buallica qumështore, dele, dhi, dosa për riprodhim, bletë dhe pula për prodhimtarinë e vezëve do të bëhet pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve sipas numrit të krerëve, familjeve të bletëve dhe numrit të Pulave për prodhimtarinë e vezëve të verifikuar nga inspektorët e AZHB. Pagesat bëhen në xhirollogaritë bankare të fermerëve, verifikimi i së cilës është bërë gjatë aplikimit.

15. Implementimi i programit

Implementimi i programit bëhet nga Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë.

16. Buxheti

Buxheti i planifikuar për pagesat direkte në sektorët e prodhimtarisë blegtorale është:

- Lopë dhe buallica qumështore: 2,000,000.00 €
- Dele dhe dhi: 1,300,000.00 €
- Bletari: 500,000.00 €
- Qumështi sipas kategorive të cilësisë: 1,500,000.00 €
- Pulat për prodhimtarinë e vezëve: 250,000.00 €
- Derraria: 200,000.00 €